



Ne baze te nenit 12, paragrafi 2, shkronja (d) lidhur me nenin 40, të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008”, e në mbështetje të Raportit përfundimtar mbi vlerësimin e “Zonës Industriale” dhe “Agro-Zonës Industriale” në Samadrexhë 01-Nr-052-20270 të datës 04.04.2025 dhe konform nenit 15, lidhur me nenin 29, pika 2 te Statutit te Komunës se Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datën -----, miraton këtë:

Projekt-V E N D I M

Neni 1

- 1.1 Kuvendi i Komunës së Suharekës pas shqyrtimit të Raportit përfundimtar mbi vlersimin e “Zonës Industriale” dhe “Agro-Zonës Industriale” në Samadrexhë 01-Nr-052-20270 të datës 04.04.2025 i hartuar nga komisioni për mbikëqyrjen e zbatimit të kontratave për shfrytëzimin e tokës ndërtimore dhe bujqësore në “Zonën Industriale” në Shirokë dhe “Agro-Zones Industriale” në fshatin Samadrexhë i themeluar nga Kryetari i Komunës së Suharkës me vendimin 01-Nr-410-22499 të datës 04.04.2023 vendosi që:
- 1.2 Të gjithë përfituesëve të vendosur në tokën ndërtimore dhe bujqësore sipas të kontratave të cekura në raportin e lartcekur të komisionit të ju jepet afat e prej një (1) viti, për përmbushjen e kontartes në fjalë (paisja me leje të ndërtimit dhe realizimin në tërësi të investimeve) pas këtij afati nëse nuk përmbushet kontrata, bëhet shkëputja e njëanshëm të kontratës me automatizëm dhe pala e humb te drejtën për ankesë si ne procedurën administrative po ashtu edhe ne procedurën gjyqësore.

Neni 2

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është edhe Raporti me numër të protokollit 01-Nr-052-20270 të datës 04.04.2025 i hartuar nga komisioni për mbikëqyrjen e zbatimit të kontratave për shfrytëzimin e tokës ndërtimore dhe bujqësore në “Zonën Industriale” në Shirokë dhe “Agro-Zones Industriale” në fshatin Samadrexhë.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për shërbime pronsore juridike dhe kadaster në Komunën e Suharekës.

Neni 4

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 30, ditë pas dërgimit në organin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me neni 9, të Ligjit Nr. 08/L-284, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, publikuar në “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 24/2024” dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve dhe faqen zyrtare të Komunës.

K U V E N D I I K O M U N Ë S N Ë S U H A R E K Ë

Kryesuesi i Kuvendit

01-Nr-_____
Me datë_____

Mr.ec Bexhet KUÇI